



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 8.1.2025

Nr: 8

Ora: 13:00

**VENDIM**  
**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË PUKË, ME KANDIDATIN**  
**NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALDEMOKRATE”, ZJ. LEZE**  
**NDREK KOLAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 1966/2 prot., datë 28.10.2024, Këshilli i Bashkisë Pukë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Klodisa Ded Qelesi, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, and 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, për Këshillin e Bashkisë Pukë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 08, zj. Leze Ndrek Kolaj.

Me shkresën nr. 3165, prot., datë 06.11.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Pukë, zj. Leze Ndrek Kolaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: 8.1.2025 Nr: 8  
Ora: 13:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialdemokrate”, zj. Leze Ndrek Kolaj”

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialdemokrate ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër SHK-PSD-13231\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Leze Ndrek Kolaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 3456 prot., datë 06.12.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 3455 prot., datë 06.12.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Leze Ndrek Kolaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar, zj. Leze Ndrek Kolaj, në Këshillin e Bashkisë Pukë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 19104/1 prot., datë 18.12.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Leze Ndrek Kolaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Leze Ndrek Kolaj, në Këshillin e Bashkisë Pukë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## **V E N D O S:**

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, zj. Leze Ndrek Kolaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**